



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “ULZA” Sh.p.k, me numër Nipt-i: J679029280, me seli:
*Tiranë, Tiranë, TIRANE, Njësia bashkiake nr. 5, rruga “Zef Jubani”, ndërtesa 15,
hyrja 19, ap. 1, kodi postar 1019.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Punë”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-39815-08-25-2022.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Mustafa Gjestila”, Burrel”,
me fond limit në vlerën: **100 192 722.5** (njëqind milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet e dy pikë pesë) **lekë pa TVSH, ndarë për vitin 2022 në vlerën: 20 038 545** (njëzet milion e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e pesë) **lekë pa TVSH**, nga buxheti i shtetit: 18 337 806.67 (tetëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, dhe nga grandit i bashkisë: 1 700 738.33 (një milion e shtatëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për vitin 2023 në vlerën: 71 306 390 (shtatëdhjetë e një milion e treqind e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH**, nga buxheti i shtetit: 66 826 007.5 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e shtatë pikë pesë) lekë pa TVSH, nga grandit i bashkisë: 2 922 650 (dy milion e nëntëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 1 557 732.5 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2024 në vlerën: 8 847 787.5 (tetë milion e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesë) **lekë pa TVSH**, nga grandit i bashkisë: 5 308 333.3 (pesë milion e treqind e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tre) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 3 539 454.2 (tre milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) lekë pa TVSH, me afat realizimi: **9 (nëntë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 117, datë 29 Gusht 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: **“ULZA”** Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J679029280**
Vlera: **98 447 456** (nëntëdhjetë e tetë milion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: **“Egeu Stone”** Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L63916002I**, dhe **“BE - IS”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71412003A**,
Vlera: **99 731 998.42** (nëntëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë dyzet e dy) **lekë pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: **“Egeu Stone”** Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L63916002I**, dhe **“BE - IS”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71412003A**,

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejti se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, shoqëria **“Egeu Stone” Sh.p.k.**, dhe shoqëria **“BE - IS” Sh.p.k.**, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi nuk kanë paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- ***Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;***

ose

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore
 - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
 - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
 - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
 - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
 - vii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.
- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
 - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
 - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
 - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, anëtari i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, shoqëria “Egeu Stone” Sh.p.k., nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas gërmës “a” dhe “b” për vërtetimin e punimeve të kryera nga ana e saj me ente publike, dhe në sektorin privat.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- **Pajisje hidrosanitare dhe hidraulike**

- Pajisje elektrike
- Pajisje hidroizoluese dhe termoizoluese
- Bojë hidroplastike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.**
2. **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.**

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. **Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme.**
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar.**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “a” dhe “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

a) *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:*

- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili strukturist)**
- **Minimuni 1 (një) Arkitekt**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Elektronik**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Përveç inxhinierave të kërkuar më lart, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf ndihmës për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libeze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi ndihmës inxhinierik si më poshtë:

- *Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*
- *Minimuni 1 (një) Arkitekt*
- *Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeofizike /Sizmiologji inxhinierike*

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi bazuar në deklaratat sipas Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të paraqitur nga të 2 (dy) shoqëritë në bashkim, nuk kanë deklaruar se disponojnë minimumi 1 (një) inxhinier Ndërtimi (Profili Strukturist), si drejtues teknik, dhe minimumi 1 (një) Inxhinier Gjeofizike /Sizmiologji inxhinierike të punësuar si staf ndihmës për kryerjen e punimeve objekt kontrate.**

V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “c”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

c) *Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi 27 (njëzet e shtatë) punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:*

- *Teknik ndërtimi – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Teknik hidraulik – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Murator/ Suvatues – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Specialist elektrik – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Specialist elektronik – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Specialist kondicionimi – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Hidraulik – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Karpentier – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Hekurkthyes – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Saldator – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Bojaxhi – jo më pak se 2 (dy) punonjës*

** Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/ çertifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi bazuar në deklaratat sipas Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të paraqitur nga të 2 (dy) shoqëritë në bashkim, nuk kanë deklaruar se disponojnë punonjësit e specializuar/ kualifikuar si: Teknik hidraulik – jo më pak se 1 (një) punonjës, Specialist elektronik – jo më pak se 2 (dy) punonjës, dhe Specialist kondicionimi – jo më pak se 2 (dy) punonjës**

VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “d”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- d) *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 10 (dhjetë) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për përdorim dhe punime në skela, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dhe çertifikatat përkatëse.*
- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi bazuar në deklaratat sipas Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të paraqitur nga të 2 (dy) shoqëritë në bashkim, nuk kanë deklaruar se disponojnë të paktën 10 (dhjetë) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për përdorim dhe punime në skela.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “**ULZA**” Sh.p.k., me seli: Tiranë, Tiranë, TIRANE, Njësia bashkiake nr. 5, rruga “Zef Jubani”, ndërtesa 15, hyrja 19, ap. 1, kodi postar 1019, me numër Nipt-i: **J679029280**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **98 447 456** (nëntëdhjetë e tetë milion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, është **identifikuar si Oferta e suksesshme.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Titullari i Autoritetit Kontraktor